

GIOVANNI BELLUSCIO

**SA TË PËRSHTATSHME JANË RREGULLAT E PIKËSIMIT
NË RASTIN E GJUHËS SË FOLUR?**

0. Hyrje

A. Xanoni [Antonio Zannoni] (1909:20–21) duke trajtuar shenjat e pikësimi i lidh ato drejtpërdrejt me “të folurit” me gojë¹ dhe jep dy shpjegime, duke i lidhur ato: **a)** me ritmin e të folurit, d.m.th. me pauzat («pushimin»), pra shenjave kryesore u jep një vlerë “kohore” (1, 2, 3, 4 «*kohe*») dhe me intonacionin; **b)** me sintaksën dhe me organizimin e shkrimit (v. r., në të dy listat që vijojnë shtesat në kllapa katrore nuk janë në tekstin origjinal):

a)

Ndala [shënjon pushimin] e *kater* kohve, e me ket shêi zâni ulet kreit.

Dy pikat [shënjon pushimin] e *tri* kohve;

Pikpresa [shënjon] pushimin e *dy* kohve;

Presa shënjon pushimin e *nji* kohes e i nepet zânit si nji t’ ulun t’ vierrët;

b)

Ndala vëhet n’fund t’propozicionit, kuer ky â vetun, e n’fund t’vargut e t’ligjerates e ç’ do shkrimi.

Piesët e përgiashme t’ ndoi propozicionit, e tiera propozicione t’shkurta ndahen me *presë*.

Rregullat që jep Xanoni (1909) për shqipen e kohës së tij (të cilat, me sa duket, mbështeten në traditën e shkrimit të italishtes dhe në atë të traditës klasike latine) mund t’i hasim edhe në gramatikat shkollore për mësimdhënien e gjuhës italiane, në të cilat jepet po ashtu vlera e zgjatjes së

¹ «*Shênjet e Pikave. Piksija*. – Nieri kuer flet pushon kû mâa pak, kû mâa shum, e kto pushime i kallxoim n’shkrim me shênje piksijet.»

pauzave në të folur për t'u mësuar nxënësve përdorimin e shenjave kryesore të pikësimit. Pas dyzet vitesh, K. Cipo (1949) vazhdon në të njëjtën hulli të Xanonit, duke marrë parasysh dy kategoritë kryesore që lidhen me përdorimin e pikësimit: atë kohore dhe atë sintaksore:

“*Presja*. Rregulla të prera se ku duhet vënë presja nuk kemi [...] 1. Për të bërë një pushim të vogël midis dy mendimesh gjatë këndimit të një cope ose për të ndërruar tonin. [...] pastaj vazhdon me 10 pika të tjera);

Pikëpresja. Tregon grafikisht një pushim më të madh se ai i presjes; është, që ta themi pak ndryshe, një presje e përforcuar [...].

Dy pikat. Tregojnë një pushim që nuk është as më i madh, as më i vogël se ai i pikëpresjes [...]

Pika. Pikën e vëmë në fund të periodës, d.m.th. kur e kemi shprehur tërësisht mendimin tonë.”

Siç mund të vërehet, mendimi i dy autorëve përputhet, ndryshon vetëm pasqyrimi i “rregullave” të përdorimit, të cilat në gramatikën e Cipos janë më të shumta dhe më të hollësishme, dhe këndvështrimi: Xanoni e shikon përdorimin e shenjave të pikësimit nga ana e të folurit (pra nga transformimi i tij në tekst të shkruar), kurse K. Cipo nga ana e lexuesit (pra nga transformimi i një teksti të shkruar në të folur).

0.1. Në këtë studim ne do të nisemi pikërisht nga këndvështrimi i Xanonit, d.m.th. nga transformimi i një materiali të gjuhës së folur në tekst të shkruar. Kur merret në shqyrtim gjuha e folur reale vihet re, menjëherë, se rregullat “praktike” ashtu siç i njohim, për të “pikësuar” materialin gjuhësor në rastin e transkriptimit të tij, duket që nuk na ndihmojnë dhe nuk i përshtaten aq lehtë rrjedhës së të folurit spontan. Por deri në ç’nivel shenjat kryesore të pikësimit (pika, presja, pikëpresja dhe dy pikat)² mund t’i përshtaten të folurit spontan? Për shembull, nëse konsiderohet aspekti “kohor” i të folurit, pra sidomos i pauzave, a ka mbivendosje të mirë midis tyre dhe shenjave të pikësimit? Do të mjaftojnë pauzat apo duhet marrë në

² Shenjat e pikësimit, sipas gramatikave, normalisht ndahen në *shenja pauze* (pika, presja, pikëpresja, dy pikat) dhe *shenja intonacioni* (pikëpyetja, pikëçuditja, pikat, thonjëzat, kllapat dhe/ose vizat e gjata). Ne këtu do të merremi vetëm me shenjat e pauzave të cilat paraqiten si më problematike (lidhur me përdorimin në të folurit spontan), edhe për faktin që materiali i zgjedhur për këtë kontribut nuk përmban shenja intonacioni. Megjithatë, edhe shenjat e intonacionit kanë lidhje me pauzat, si edhe shenjat e pauzave, siç do të shohim, kanë lidhje me intonacionin.

konsideratë edhe ana tjetër e analizës, d.m.th. e aspektit intonacionor të gjuhës?

Duke u nisur nga analiza e dy shembujve, njëri i *të folurit publik spontan* (të një ministri në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë) dhe tjetri i *të folurit të emetuar* (në televizion), në këtë kontribut do të vihet në dukje problematika e transkriptimit dhe e përdorimit të shenjave të pikësimit. Ka disa dekada që merremi me gjuhën e folur dhe me transkriptime të të folurit real (transkriptime fonetike dhe alfabetike) dhe falë kësaj përvoje shumëvjeçare, gjatë së cilës na u desh të përballonim një sërë problemesh lidhur p.sh. me segmentimin e fjalëve (sidomos kur bëhet një transkriptim fonetik dhe kur duhet bërë zgjedhja midis ndarjes së njësive leksikore sipas strukturës së gjuhës ose paraqitjes së natyrshme të rrjedhshmërisë së sinjalit akustik, me ndarje në përbërës më të gjatë si sintagma ose se grupi frymëmarrës), arritëm të vendosim një metodë që më së miri i përshtatet segmentimit të materialit si edhe përshkrimit të tij pasi u përzgjedh edhe niveli i analizës. Lidhur me këto çështje paraqitet pra edhe problemi me të cilin do të merremi këtu: a duhen përdorur (ose: a mund të përdoren) shenjat e pikësimit sipas rregullave kanonike të gramatikës kur zgjedhim të bëjmë një transkriptim? Pra, sa të përshtatshme janë ato shenja në rastin e të folurit spontan?

1. Materiali

Për këtë studim zgjodhëm dy fragmente me të folur spontan: A) I pari është një shembull i një ndërhyrjeje në foltoren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, më datë 28 janar 2016, nga një deputet (I. B. 48 vjeçar, me formim të lartë, lindur në Tiranë, në atë kohë ministër i shëndetësisë), pra kemi të bëjmë me një regjistër të lartë në një kontekst zyrtar. Fragmenti u zgjodh për dy arsye: e para, sepse për një analizë të të folurit spontan duhej një incizim i mirë dhe, po të ishte e mundur, edhe një video e folësit; e dyta, sepse për të njëjtën incizim na duhej edhe një transkriptim (orto)grafik, i cili, në rastin tonë, u siguroi falë procesverbaleve të Kuvendit³. Siç mund të vihet re nga videoja e fjalimit⁴, folësi herë pas here

³ Për pauzat në gjuhën e folur ka një literaturë të larmishme. Çështja e pauzave në të folur tërhoqi aq shumë interesin e gjuhëtarëve sa u desh të themelohej një disiplinë e posaçme me emër “pauzologji”. Deri sot për shqipen nuk kemi studime në këtë fushë. Në mënyrë skajore, lidhur me studimin e përshpejtimit të të folurit (*Speech Rate* dhe *Articulation Rate*), Belluscio (2012, 2016 dhe 2017) u mor me matjen dhe me vlerësimin e pauzave frymëmarrëse të shqipes. Nga materiali ynë

mbështetet në një tekst të shkruar (ndoshta shënime), të cilit i referohet disa herë gjatë fjalimit. Fragmenti zgjat 113 sekonda dhe të folurit e tij mund të konsiderohet spontan. **B)** Një fragment i shkurtër (rreth 23 sekonda) i shqiptuar nga një spiker/gazetar i televizionit privat kosovar RTK (A. K. 36-vjeçar, lindur në Prishtinë), në një emision të tipit debat që u dha në prill të vitit 2015. Edhe në këtë rast gjuha e folur është spontane, por mbështetet në një tekst të shkruar (shih më poshtë paragrafin 4).

2. Analiza

2.1. Fragmenti **A** i të folurit u nda së pari në 63 njësi sipas pauzave (të cilat janë fiziologjike, për frymëmarrjen, si dhe shprehëse, d.m.th. pragmatike ose retorike). Pas kësaj ndarjeje perceptive, duke përdorur programin *Praat* (i cili konsiderohet sot si program standard për analizën fonetike akustike), u verifikuan nëpërmjet dëgjimit dhe vrojtimit, ndarjet e njësive shprehëse (“grupet frymëmarrëse” ose “grupet brendapauzore”, shih TEKSTIN 2). Për secilën njësi u matën: 1) pauzat e pasme; 2) frekuenca e formantit themelor (F_0 = frekuenca e dridhjes së tejjave të zërit) në fillim dhe në fund të secilës njësi. Këto dy matje u bënë për të kryqëzuar dy aspekte objektive që merren si kritere për shënimin e shenjave të pikësimit: gjatësia e pauzave dhe intonacioni i të folurit. Në materialin e përzgjedhur (sipas transkriptimit në procesverbalin⁵ që japim

gjetëm konfirmim të konceptit shprehur prej Halliday-t (1992:76) kur thotë se në të folurit natyral pauzat, në shumicën e rasteve, lidhen me kufijtë gramatikorë, kurse, mund të ndodhë që folësi të ndalet në mes të strukturës kur i del përpara një fjalë e papritur ose e rrallë, e cila ka një frekuencë shumë të vogël ose nuk është e paralajmëruar nga konteksti. Pauzave u është kushtuar një tubim shkencor ndërkombëtar në Kassel të Gjermanisë më 13–17 qershor 1978, dhe aktet e tubimit janë përmbledhja e parë e plotë dhe e shumanshme e kësaj çështjeje (shih Dechert, Raupach 1980).

⁴ Fragmenti i zgjedhur fillon nga minuta 2.19.20 në faqen web

www.youtube.com/watch?v=oIGmP7bSK4Y.

⁵ Një aspekt që duhet mbajtur parasysh është fakti që procesverbalet nuk shënojnë të folurit real të folësit, d.m.th. verbalizuesi (nuk dimë me saktësi cila është procedura në Kuvendin e Shqipërisë për shkrimin e procesverbaleve, nuk dimë nëse në sallë ka stenografë që verbalizojnë drejtpërdrejtë gjatë seancës, apo nëse transkriptimi bëhet pas seancave duke u mbështetur në regjistrimin e fjalimeve) nuk regjistron me shkrim tekstin ashtu siç e shqipton folësi. Në rastin tonë kemi vënë re se teksti u përmirësua dhe u përshtat sipas “modelit” të gjuhës së shkruar. Më poshtë do të japim tekstin e procesverbalit duke shënuar me shkronja të zeza

në vijim) kemi të bëjmë vetëm me përdorimin e *presjes* dhe të *pikës*, pra qëllimi i këtij studimi është kryesisht të verifikohet niveli i mbivendosjes së shenjave të pikësimit në bazë të materialit origjinal të prodhuar nga folësi, si edhe në ç'masë ka ndërlidhshmëri midis pauzave (të gjitha) dhe përzgjedhjes së shenjave të pikësimit nga transkriptuesi⁶. Në raport me këtë aspekt u vendos të konsiderohet, së bashku me pauzat, edhe ecuria e njësisë intonacionore për secilin “grup brendapauzor”.

2.2. Fragmenti “B” propozohet këtu si shembull, le të themi ‘kanonik’, për të vënë në dukje deri në ç’nivel mund të arrijë ndërputja e pauzave duke këputur në mënyrë të pashpjegueshme rrjedhën e të folurit. Të konsiderohet sidomos fakti që fragmenti përfaqëson sekondat e para të hapjes së emisionit televiziv dhe është shqiptuar nga një gazetar i ri, por me përvojë.

ndryshimet e bëra nga transkriptuesi. Për një trajtim gjithëpërfshirës të problemeve lidhur pikërisht me transkriptimin e fjalimeve në kuvend, për sa njohim, nuk kemi materiale që i referohen shqipes. Një kontribut në këtë drejtim e jep Hamiti (2017), e cila analizon gjashtë transkriptime zyrtare të Kuvendit të Kosovës dhe i krahason me transkriptimet e veta të po të njëjtëve fjalime, duke vënë në dukje “normalizimin standardizues” nga ana e transkriptuesit e të folurit “me nuanca dialektore” të deputetëve kosovarë. Për një këndvështrim paralel të çështjes së transkriptimeve të fjalimeve në parlamentin italian shih analizën e thelluar prej Cortelazzo-s (1985).

⁶ Po ngulim këmbë këtu për të vënë në dukje pamundësinë për të vendosur cila është origjina e transkriptimeve në procesverbalin e botuar. Materiali origjinal i transkriptuar (edhe me disa gabime) gjendet në faqen web <https://www.parlament.al/Files/Informacione/libri-1-2016.pdf> (PUNIME TË KUVENDIT. Seancat plenare. Viti 2016, 1, Botim i Kuvendit, Tiranë, 2017. Përgatiti për botim Drejtoria e Shërbimit të Botimeve Parlamentare), por nuk jemi të sigurt nëse teksti është po ai që deputeti kishte në dorë në foltore apo është transkriptimi sipas të folurit të tij. Ne pretendojmë ta konsiderojmë si transkriptim (pra “verbalizim” i mirëfilltë) i fjalëve që u thanë në Kuvend, e mendojmë këtë gjë edhe në bazë të ndërhyrjeve të tjera të Kryetarit të Kuvendit dhe të shënimeve në kllapa me shkronja të pjerrëta, si p.sh.: (Ndërhyrje nga salla), (Ndërhyrje pa mikrofon), (Zoti Noka ndërhyr pa mikrofon), (Deputeti Taulant Balla vazhdon të flasë nga vendi pa mikrofon) etj. Nga një komunikim gojor me kolegen A. Çerpja, të cilën e falënderojmë për këtë informacion, mësuam se Drejtoria e Shërbimit të Botimeve Parlamentare, në përgjithësi bën zbardhjen e regjistrimeve audio të seancave, pra ky transkriptim duhet konsideruar si pasqyrim i të folurit real në Kuvend.

2.3. Paraqesim tani materialet që u zgjodhën për analizën dhe vlerësimin e përdorimit të shenjave të pikësimit në procesverbalin e Kuvendit (TEKSTI 1) dhe, në vijim, po të njëjtin tekst të ndarë sipas grupeve frymëmarrëse ose intonacionore (TEKSTI 2), i cili është rezultat i transkriptimit që kemi bërë nga audioja origjinale e fjalimit në Kuvend, pra ai përfaqëson gjuhën e folur spontane (italisht “il parlato”) të subjektit folës I. B. Në TEKSTIN 3, japim Tekstin 2 me shenjat e pikësimit të vendosura (sipas përmbajtjes së tekstit, pra jo sipas audios origjinale) nga një gjuhëtare sintaksologje që ka shqipen si gjuhë amtare⁷.

2.4. **TEKSTI 1** (Transkriptimi zyrtar sipas Procesverbalit e Kuvendit. Në kllapa katrore jepen shenjat origjinale të pikësimit).

Siç u tha edhe më sipër, ky transkriptim del si i “redaktuar” në krahasim me incizimin e fjalimit në podium, në të cilin dalin disa përsëritje dhe një pakujdesi nga ana e folësit (si p.sh. në rastin e sasisë së grave që kanë bërë kontrollë pa pagesë, kur folësi në vend që të japë shifrën 165.000 jep 165 dhe vazhdon fjalimin), i cili, pas korigjimit nga ana e deputetëve në sallë (në audio dëgjohen murmurima), jep shifrën e korigjuar dhe vazhdon me fillin e diskursit.

“**Iir Beqja** [SIC] –

I nderuar drejtues i seancës[,] Zonja dhe zotërinj deputetë[,]

Sapo u tha këtu që në emër të grave duhet të ngremë një kauz [SIC *kauzë*] për çështjet e shëndetësisë[.] Unë fillimisht po ndaj me publikun shqiptar[,] sidomos me zonjat e Shqipërisë[,] këto informacione[.] Që nga dita kur kontrolli bazë pa pagesë ofrohet në Shqipërisë [SIC][,] atë e kanë kryer 165 mijë zonja[,] ndërkohë që nga dje[,] për këdo që jeton në Shqipëri[,] ka një lajm të ri[,] shumë të mirë[,] mjeku i familjes ofrohet falas për këdo që jeton në Shqipëri[.] Nuk ka qenë kështu deri pardje[,] ku në bazë të asaj pseudoreforme[,] që ju bëtë në vitin 2011 dhe në bazë të asaj që ju latë[,] u ofrohej mbulim me kujdes shëndetësor vetëm 2,3 milionë shqiptarëve[,] ndërsa nga dje mjeku i familjes i ofrohet kujt do që jeton në Shqipëri[.] Pa dyshim këto 600 mijë vetë[,] normalisht mund të

⁷ Falënderoj kolegen Flora Koleci, e Universitetit të Tiranës, për ndihmën dhe durimin që pati duke “pikësuar” dy herë këtë tekst: herën e parë duke u mbështetur vetëm në procesverbalin origjinal të cilit i hoqëm paraprakisht të gjitha shenjat e pikësimit dhe herën e dytë në transkriptimin tonë të audios, duke konsideruar edhe ndryshimet midis dy teksteve.

themi që gjysma janë zonja[,] vajza dhe gra dhe sigurisht nuk janë as fëmijë[,] pasi ata janë të mbuluar dhe as pensionistë[,] pra janë nëna dhe gra[,] zonja shtëpie[,] prindër të cilët mbajnë familjet e tyre[.] Deri pardje[,] nëse kishin nevojë për kujdes shëndetësor[,] duhej të paguanin gjithçka nga xhepi[,] ndërsa nga dje ato që janë mbi **42**⁸ vjeç[,] përveç kontrollit parandalues[,] që e kanë të garantuar prej 1 viti[,] kanë edhe mjekun e familjes[.]”

2.5. **TEKSTI 2** (transkriptimi ynë sipas audios origjinale të fjalimit)

Në shtyllën **A** japim rendin e fragmenteve; në shtyllën **B** japim me shkronja të pjerrëta transkriptimin e grupeve frymëmarrëse ose të grupeve intonacionore (sipas pauzave) me shenjat e pikësimit sipas procesverbalit; në kllapa gjarpërushe japim shenjat e pikësimit të vendosura nga gjuhëtarja sintaksologje; me shkronja të trasha japim fjalët ose pjesët që folësi tha në fjalim, por që nuk u dhanë në transkriptimin e Procesverbalit zyrtar; në kllapa katrore japim transkriptimin fonetik të gjerë me theksat kryesorë dhe dytësorë; në disa grupe me shenjën | shënohen ndarje me pauza të brendshme tejet të shkurtra. Në shtyllën **C** japim shenjat e pikësimit që u përdorën në secilin grup në Procesverbal. Në shtyllën **Ç** japim zgjatjen e pauzave fundore për secilin grup (në pak raste jepen dy vlera të ndara me shenjën | të cilat u referohen dy pjesëve të të njëjtit grup që janë ndarë nga një pauzë e brendshme e shkurtër). Në shtyllat **D** dhe **DH** jepet vlera e frekuencës themelore F0 në Hz (e matur automatikisht nga program *Praat*) në fillim dhe në fund të secilit grup; kjo matje na jep mundësinë që të vlerësojmë nëse grupi në shtyllën **B** ka prirje të ketë një intonacion ngjithës apo zbritës, tipologjia jepet në shtyllën **E** ku: **n** = intonacion ngjithës, **z** = intonacion zbritës.

Pjesa e zgjedhur nuk paraqet hezitime dhe pauza të plota, d.m.th. me vokalizime, folësi përdor një shqiptim të rrjedhshëm, me një “intonacion/ritëm” tipik të regjistrit të politikës, ku kemi një emfazë të konsiderueshme dhe një fragmentim të rrymës së të folurit. Mënyra se si paraqitet gjuha e folur kur transkriptohet, në krahasim me gjuhën e

⁸ Në këtë rast, si edhe në rastin e grupit frymëmarrës n. 5 të TEKSTIT 2, shqiptimi i përshpejtuar dhe strategjitë kohore të vetë shqipes (gjuhë që paraqet një erozion të lartë të rrokjeve të patheksuara, dukuri tipike e gjuhëve me izokroni theksore, shih Belluscio et al. 1997) nuk na mundësuan të kuptonim numrin. Procesverbali jep 42, por nga shqiptimi na duket më së miri 40.

shkruar, paraqitet me një trajtë që mund të vlerësohet si “pa formë”, por kjo është natyrshmëria e të folurit, i cili (në përgjithësi) nuk është i destinuar për t’u shndërruar në shkrim⁹ (Halliday 1992:144).

A	B	C-She-rijate p.kë-simit	C-Pauza në qirdata të sekondës	D-F0 (Hz) në fillim	DH-F0 (Hz) në fund	E-Ecuria e intona-donit
1	<i>I nderuar drejtues i séances, {,}</i> [inde'ruardrej,tueşise'antsəs]	,	73	137	143	n
2	<i>Zonja dhe zotërinj deputetë,{!/,}</i> ['zoŋaðezot,rindep'u'tet ^h]	,	222	120	106	z
3	<i>sapo u tha këtu që {,}</i> ['sapouθak'tucə::]		102	168	147	z
4	<i>në emër të grave {,} duhet të ngrejmë një kauzë</i> [ne,emərtg'raveduetŋgremŋ'kauz]		39	146	99	z
5	<i>për çështjet e shëndetësisë.{,}</i> [pɥ ³ ,eʃəndet'si:s]	.	125	136	99	z
6	<i>Atëherë unë{,} fillimisht{,}</i> [ate'rünfi'ti'mijt]		53	164	183	n
7	<i>po ndaj me</i> [,pon'dajme::]		18	144	130	z
8	<i>publikun shqiptar, {,} por sidomos me zonjat e Shqipërisë, {,}</i> [publikunʃip'tar porsido'mos mezoŋateʃipə'ris]	,	102	152	163	n

⁹ Kjo e vërtetë bie në kundërshtim me përdorimin e gjerë të transkriptimeve në epokën e mjeteve të komunikacionit të masës. Le të konsiderohen, p.sh., lajmet, që kanë si origjinë fjalimet/deklaratat “me gojë” të politikanëve (si në rastin tonë), të personaliteteve të ndryshme të shkencës, të letërsisë, të sportit, të modës etj., si edhe të gjitha materialet e transkriptuara, siç janë p.sh. përgjimet telefonike ose ambientale, regjistrimet në sallat e gjyqit, aktet parlamentare etj. Pra, çdo ditë, duke përdorur mjete të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme, një masë e madhe e të folurit spontan ndryshohet në tekst të shkruar. Me të gjitha problemet që ky proces sjell me vete.

Sa të përshtatshme janë rregullat e pikësimit në rastin ...

9	edhe këtë informacion {,} [,eðektəimforma'tsjon]		59	147	105	z
10	<i>këto informacione</i> . {,} [,ktoimforma'tsjone]	.	103	167	105	z
11	<i>që nga dita</i> [,cəŋga'di-ta]		69	190	115	z
12	që kontrolli shëndetësor bazë pa pagesë ofrohet në Shqipëri, {,} [cəkon'ərotifəndet,sorba:zpapa'ges of,rohet nʃ'ip'ri]	,	57	157 161	137 173	n
13	<i>e kanë kryer</i> [ekank'ryer]		28	146	184	n
14	<i>një qind e gjashtëdhjetepesë</i> / <i>zonja</i> , {,} [nɪ'cin ^d eɟazðete'pes / 'zɔŋa]	,	136	142	85	z
15	<i>ndërkohë</i> [ndə'ko:]		72	133	238	n
16	<i>që</i> {,} <i>nga dje</i> , {,} [,cəŋga'dje]	,	164	171	223	n
17	<i>për këdo që jeton në Shqipëri</i> , {,} [pərkə'docje,tɔnʃip'ri:]	,	117	170	221	n
18	një qind e gjashtëdhjetepesë mijë ['cin ^d e,ɟaʃtepe-s'mi:]		40	198	105	z
19	zonja {,} ['zɔja]		61	121	88	z
20	që nga dje [,cəŋga'dje:]		77	199	258	n
21	<i>ka një lajm të ri</i> , {,} [kaɲ,lajmt'ri:]	,	37	204	142	z
22	<i>shumë të mirë</i> ,{:} [,ʃumtə'mir]	,	92	215	90	z
23	që nga dje [,cəŋga'dje]		69	194	246	n
24	<i>mjeku i familjes</i> [,mje-kuifa'miljes]		19	143	114	z
25	<i>ofrohet falas</i> [of'rohet'falas]		22	159	212	n
26	<i>për këdo që jeton në Shqipëri</i> . {,} [pərkə'do cje,tɔnəʃip'ri]	.	134	191 215	186 98	z

27	<i>Nuk ka qenë kështu deri pardje, {,}</i> [ˈnukacən, kʲtuderiparˈdʲe]	,	92	161	107	z
28	deri pardje [ˈderiparˈdʲeː]		58	166	259	n
29	<i>në bazë të asaj</i> [nəˈbaztaˈsaj]		56	147	253	n
30	<i>pseudoreforme, që ju bëtë në dymijenjëmbëdhjetën</i> [ˈpsudoreˈformecʰju, bətdymijenəmˈ ðjetən]	,	69	230	232	=
31	<i>në bazë të asaj çfarë latë, {,}</i> [nˈːˈbazta, saɪffarˈla:tʰ]	,	60	149	391	n
32	<i>u ofrohej</i> [.iofˈro-i]		27	219	98	z
33	<i>mbulim</i> [mbuˈlim]		22	160	200	
34	<i>me kujdes shëndetësor</i> [mekuj, deɟəndetˈso:r]		10	170	224	n
35	<i>vetëm dy pikë tre milionë shqiptarëve, {,}</i> [vetənˈetən pikt, remiljonˈipˈtarve]	,	10 46	230 257	259 89	
36	<i>nga dje {,}</i> [ŋgaˈdʲe]		58	165	262	n
37	<i>mjeku i familjes</i> [.mjekuifaˈmiljes]		35	138	224	n
38	<i>i ofrohet kujt do që jeton në Shqipëri. {,}</i> [iof, roet kujˈtː do cjeˈtonɟipˈri]	.	59	239	93	z
39	dhe pa dyshim {,} [.ðepadyˈɟim]		61	129	268	n
40	<i>këto gjashtëqind mijë vetë, {,}</i> [ktoˈɟaɟcimiˈvetʰ]	,	70	218	194	z
41	<i>normalisht mund të themi</i> [normaˈorɟmunˈdːi θemi]		-	114	155	n
42	<i>që gjysma janë zonja, {,}</i> [cəˈɟysmajanˈzɔna]	,	-	171	224	n
43	<i>vajza dhe gra</i> [.vajzaðegˈra]		80	139	322	n
44	<i>dhe {,} sigurisht {,}</i> [ðesiguˈriɟt]			169	250	n

Sa të përshtatshme janë rregullat e pikësimit në rastin ...

45	<i>nuk janë as fëmijë</i> , {,} [nu'kjanasf'mi:]	,		169	353	n
46	<i>se ato janë të mbuluar</i> , {,} [sea'toʃanmbu'luar]			189	228	n
46 a	<i>nuk janë as pensionistë</i> , {,} [nu'kjanaspensjo'nist]	,	59	218	128	z
46 b	<i>pra janë</i> , {,} ['praja-n]		21	147	132	z
47	<i>nëna dhe gra</i> , {,} ['nəna ðeg'ra:]	,	132	129 131	345 203	
48	<i>zonja shtëpie</i> , {,} ['zoŋa'pie]	,	123	185	226	n
49	<i>dhe prindër</i> , {,} dhe [ðe'prindər 'ðe:]		27	136 150	234 233	
50	<i>sigurisht</i> [sigu'rifʃt]		15	218	221	n
51	<i>mbajnë dhe familjet e tyre</i> . {,} ['mbajn,ðefamiljete'ty.re:]	.	45	183	99	z
52	<i>Deri dje</i> , {,} [deri'eri]		63	175	146	z
53	<i>deri pardje</i> , {,} [,deripar'dje]	,	53	167	226	n
54	<i>nëse kishin nevojë</i> [nəse'əse'fine'ine]		44	149	280	n
55	<i>për kujdes shëndetësor</i> , {,} [pərkuj'ər'ʃændet'so:r]	,	23	175	226	n
56	<i>duhet të paguanin gjithçka nga xhepi</i> , {,} ['duetpa'guaninjɪθ,kaŋga'dʒepi:]	,	95	173	103	z
57	<i>nga dje</i> , {,} [ŋga'dje]		88	124	331	n
58	<i>ato që janë mbi dy zet e dy vjeç</i> , {,} [a'tɔtʃjanmbiðze'ti'vjetʃ]	,	19	124	139	n
59	<i>përveç kontrollit parandalues</i> , [pər'vetʃkont,roʃinparanda'lues]	,	73	183	108	z
60	<i>që e kanë të garantuar prej një viti</i> , {,}	,	70	150 	134 	

	[tɛ'e]e katgaran'atrrprejni'viti]			129	218	
61	nga dje <i>kanë dhe mjekun e familjes.</i> {.}	.	227	137	204	
	[nga'dje kanë'e'anðe kkmjekun				93	
				167		

2.6. **TEKSTI 3** (sipas incizimit të fjalimit origjinal, me shenjat e pikësimit të vendosura nga gjuhëtarja. Në kllapa katrore shenjat ekstra që u shtuan, ndërsa të tjerat përputhen. Me shkronja të zeza pjesët e shqiptuara nga folësi por jo të transkriptuara në Procesverbal, ndërsa me vizë fshirëse pjesët që nuk dalin në incizimin e seancës parlamentare por që janë shtuar nga transkriptuesi ose, ndoshta, që e mund të kenë origjinën nga një tekst i shkruar i dorëzuar nga vet deputeti).

I nderuar drejtues i seancës, zonja dhe zotërinj deputetë, [!/,]

sapo u tha këtu që, në emër të grave, duhet të ngremë një kauzë për çështjet e shëndetësisë. **Atëherë** unë, fillimisht, po ndaj me publikun shqiptar, sidomos me zonjat e Shqipërisë, edhe këtë informacion [,] këto informacione. Që nga dita ~~që ka~~ kontrolli **shëndetësor** bazë pa pagesë ofrohet në Shqipëri, ~~atë~~ e kanë kryer 165 **zonja**, ndërkohë që, nga dje, për këdo që jeton në Shqipëri [,] **njëqind e gjashtëdhjetepesë mijë zonja** [,] **që nga dje** [,] ka një lajm të ri [,] shumë të mirë: **që nga dje** [,] mjeku i familjes ofrohet falas për këdo që jeton në Shqipëri. Nuk ka qenë kështu deri pardje, **deri pardje** ~~ka~~, në bazë të asaj pseudoreforme që ju bëtë në vitin 2011 ~~dhe~~ në bazë të asaj ~~që ju~~ **çfarë** latë, ~~u~~ i ofrohej mbulim me kujdes shëndetësor vetëm 2,3 milionë shqiptarëve, ~~ndërsa~~, nga dje, mjeku i familjes i ofrohet kujt do që jeton në Shqipëri [,] dhe pa dyshim, ~~ndër~~ këto 600 mijë vetë, normalisht mund të themi që gjysma janë zonja, vajza dhe gra dhe, sigurisht, nuk janë as fëmijë, ~~pa~~ **ata se ato** janë të mbuluar [,] pra janë [,] ~~dhe~~ **nuk janë** as pensionistë, ~~pra~~, janë nëna dhe gra, zonja shtëpie [,] ~~dhe~~ prindër, ~~të cilët~~ **dhe sigurisht** mbajnë ~~dhe~~ familjet e tyre. Deri **dje** [,] **deri** pardje, nëse kishin nevojë për kujdes shëndetësor, duhet të paguanin gjithçka nga xhepi, ~~ndërsa~~, nga dje, ato që janë mbi 42 vjeç, përveç kontrollit parandalues që e kanë të garantuar prej 1 viti, **nga dje** kanë edhe mjekun e familjes.

3. Rezultate dhe diskutim

Së pari, duhet nënvizuar fakti që, siç dihet, duke konsideruar disa parametra (si mbizotërimi i leksikut mbi sintaksën, prania e disa

“rregullave” të ndryshme, rimarrja e koncepteve ose e fjalëve, përsëritja, këputja e rrymës së koncepteve etj.), gjuha e folur dhe gjuha e shkruar janë shumë të largëta njëra nga tjetra¹⁰. Gjuha e folur, sidomos kur është spontane, paraqet një larmishmëri lidhur me kontekstin, me folësin, me argumentin për të cilin flitet, pra paraqet një gamë të gjerë variantesh gjatë boshteve diamezike, diatopike, diafazike dhe diastratike. Gjuha e folur, në krahasim me të shkruarën përfaqëson një fenomen që është i përkohshëm, pra një komunikim që realizohet “këtu dhe tani”¹¹ dhe ndërvepron vazhdimisht me kontekstin ku ndodh komunikimi dhe me *feed-back*-un në kohë reale që folësi ka me dëgjuesin/dëgjuesit. Ndryshe gjuha e shkruar, e cila është veprim “privat” si për shkruesin dhe për lexuesin, nuk ka kufizime kohore ose hapësinore, e, sidomos, është më e përsosur dhe më përfaqëson një tekst më shumë organik, sepse para se teksti të arrijë në trajtën e tij përfundimtare kalon në shumë faza të ndryshme, me rishikime, ndryshime etj.

3.1. Siç thotë Voghera (1992: 13–15), gjuha e folur paraqet “tri kuptime: 1. si komunikim gjuhësor bazë (“gjuhë [(italisht) = *linguaggio*] gojore, spontane dhe e përditshme”); 2. si kanal transmetimi (në kuptimin e përgjithshëm, të folurit që përdoret për komunikimin gojor”); 3. si tërësia e zakoneve gjuhësore të veçanta “të një ambient kulturor ose të një vendi të kufizuar gjeografikisht dhe të mirëpërcaktuar, në kundërvënje me gjuhën [= *linguaggio*] e shkruar, letrare ose zyrtare, të një ambienti të ngritur.”

¹⁰ Një trajtim të gjerë dhe të thelluar të trajtave dhe të aspekteve të stileve të gjuhës së folur dhe të shkruar (si edhe të një serie të madhe të stileve në përdorimin e shqipes) e jep Lloshi (1999), i cili mbetet deri sot kontributi më i mirë në këtë fushë. Lidhur me gjuhën e folur, vetë Lloshi pohon se për shqipen mungojnë ende studime sasiore me metoda moderne, megjithatë ndihmesa e këtij autori mbetet themelore në shumë drejtime, sidomos lidhur me shqyrtimin e hollësisht të të folurit (kr. IV *Fonostilistika* dhe kr. X *Ligjërimet e folura*) dhe të të shkruarit (sidomos kr. XI *Ligjërimi i shkruar*). Megjithëse në faqe të ndryshme të librit autori i referohet “stilit” të gjuhës së politikës, fatkeqësisht ai nuk jep të dhëna të posaçme dhe referenca lidhur me këtë stil, po ashtu shumë pak kemi gjetur për aspektin që këtu na intereson, d.m.th. për ndërlidhshmërinë e gjuhës së folur me shenjat e pikësimit. Kush do të merret sot me studimin e gjuhës shqipe të folur nuk mund të mos mbështetet në teorinë dhe në materialet e këtij kontributi shkencor.

¹¹ Megjithëse “këtuja” dhe “tanija” sot u ndryshuan në “gjithkund” dhe “çdo herë” falë mjeteve moderne, që nga krijimi i magnetofonit deri të regjistrimi digjital i sotëm, dhe falë bankave të të dhënave botërore që mund të konsultohen në internet.

Kuptohet vetiu që pozicionet e gjuhëtarëve për çështjen “gjuhë e folur – gjuhë e shkruar” janë në përgjithësi të afërta, por duke u thelluar në analizën dhe krahasimin e dy “varieteteve ose modaliteteve” ka edhe ndryshime konkrete dhe të mbështetura¹². Kjo skemë aplikohet në materialin që kemi zgjedhur për këtë analizë dhe e përfaqëson në bazë të tri kriterëve të shprehura.

Gjuha e shkruar nuk është më e strukturuar sesa ajo e folur; të folurit është “i improvizuar” (d.m.th. i atypëratyshëm) dhe, sipas Halliday-t (1992: 144), natyra e gjuhës së folur tregon një nivel të ulët të “densitetit leksikor”, çka nuk do të thotë që ai transmeton më pak kuptime. Si përfundim, Halliday (1992:152) pohon se gjuha e shkruar i paraqet dukuritë e saj si **prodhime**, ndërsa gjuha e folur i paraqet si **proces**, pra ky është ndryshimi midis diskursit të shkruar dhe diskursit të folur¹³.

3.2. Duke marrë si bazë faktin që shqipja e folur dhe shqipja e shkruar janë dy tipologji të gjuhës shqipe (ose, siç thamë më sipër: dy modalitete), por pjesa më e madhe e dy tipologjive është pikërisht e njëjta, le të shohim tani, në rastin e fragmentit të të folurit që kemi analizuar, si paraqitet gjuha shqipe e folur, si janë ndarë segmentet sipas pauzave dhe sa ndërlidhshmëri kanë pauzat me vendosjen e shenjave të pikësimit kur “modaliteti” i folur kalon në atë të shkruar.

3.2.1. *Pauzat*. Kriteri për të marrë pauzat e të folurit spontan si bazë për të verifikuar përputhshmërinë me shenjat e pikësimit (në rastin tonë të *presjes* dhe të *pikës*) në transkriptim u tregua si i paaplikueshëm. Seria e pauzave që kemi matur prezanton një ndryshueshmëri në të qindta të sekondës nga 0 te 227. Duke konsideruar se pauzat më të vogla se 20 qsek. nuk rezultojnë si jo të perceptueshme nga veshi i njeriut¹⁴, do të thotë që

¹² Për këto aspekte fatkeqësisht nuk kemi studime për gjuhën shqipe që kanë si bazë gjuhën e folur reale në variantet e saj. Literatura që mund të shfrytëzohet është pra ajo për gjuhë të huaja, si anglishtja dhe italishtja. Pa harruar se studimi i gjuhës reale të folur filloi në fund të viteve '70 dhe pati një rritje eksponenciale në vitet '80 të shekullit XX; tekste në të cilët jemi mbështetur për këtë analizë janë Sornicola (1981) dhe Voghera (1992) për italishten, ndërsa për anglishten Halliday (1992).

¹³ Shkronjat e trasha janë në tekstin origjinal. Nuk është ky vendi për t'u marrë me aspektet teorike dhe praktike, respektivisht për gjuhën e folur dhe për atë të shkruar. Literatura për këtë çështje është e gjerë dhe me një histori të gjatë pra mjafton që lexuesi t'u drejtohet librave që kemi cituar më sipër.

¹⁴ Sipas Zellner (1994) “Some pauses are more easily perceived than others, and generally, such pauses appear to support particular functions within the message,

Sa të përshtatshme janë rregullat e pikësimit në rastin ...

shenjat e pikësimit që u vendosën në intervalin 0–20 qsek. nuk mund të mbështeten në gjatësinë e pauzës, por në ndryshore tjetër (e cila, siç do të shihet, është intonacioni ose struktura e tekstit të shkruar). Segmentet 41, 42, 44, 45, 46 në *Tekstin 2* nuk paraqesin pauzë kohore (prandaj nuk kemi matje të saj), por kanë ecuri intonacionore të tillë që, përveç në rastin e segmentit 41, ndiqen nga një presje. Në rastin e *pikave*, të cilat janë shtatë në tekstin e Procesverbalit, ato u vendosën kur kemi në të folur pauza me zgjatje të ndryshme. Segmentet me *pikë* janë (në kllapa zgjatja e pauzës në qsek.): 5 (125), 10 (103), 26 (134), 38 (59), 51 (45) 61 (227), pra me një vlerë mesatare $\bar{x} = 105,5$ qsek. dhe me deviacionin standard $\sigma = 59,4^{15}$. Në rastin e *presjeve*, kampioni është më i madh dhe pauzat kanë një hapësirë 10–164 qsek. (nuk u konsiderua pauza e segmentit me 222 qsek për dy arsye: e para, sepse ka intonacion zbritës fundor, pra sikur të ishte segment mbyllës me një *pikë* në fund; e dyta, sepse në përzgjedhjen e bërë nga gjuhëtarja në fund të atij segmenti, ajo dyshon për një pikëçuditje apo për një presje. Nga ana statistike, mesatarja e gjatësisë së pauzave atje ku (në transkriptimin e Procesverbalit) u vendos një presje është 79.4 qsek. (pra minus 26,1 qsek.), kurse deviacioni standard $\sigma = 37,2$, çka tregon një homogjenitet më të madh brenda kampionit.

Në tabelën që vijon jepet ndarja e pauzave dhe tipologjia e shenjave të pikësimit me numrin e përdorur për secilin segment:

Të qindta të sekondës	Sasia e segmenteve	Pikësimi në procesverbal		Pikësimi i gjuhëtares	
		Shenja e pikësimit	Numri i shenjave	Shenja e pikësimit	Numri i shenjave
0	5	presje	3	presje	5
10–19	5	presje	1	presje	1
21–28	7	presje	1	presje	3

such as grammatical functions, semantic focus, hesitation, and so on. Also, pauses are more easily perceived if their duration is around 200–250 ms.”

¹⁵ Vendosija e pikave pothuajse përputhet midis dy teksteve (procesverbal + transkriptim), vetëm në rastin e segmentit 38 pika e procesverbalit zëvendësohet me presje, por këtu kemi të bëjmë me një ndryshim në tekstin e transkriptimit. Megjithatë vlerat e dhëna ndryshojnë pak: mesatarja 126.9 qsek., dev. st. 58.9.

35–39	3	presje	1	presje	2
40–45	3	pikë	1	pikë	1
53–59	9	presje pikë	2 1	presje	9
60–69	7	presje	2	presje	5
70–77	6	presje	4	presje	3
80–88	2	-	-	presje	1
92–95	3	presje	3	presje dy pika	2 1
102–103	3	presje pikë	1 1	presje pikë	3 1
117	1	presje	1	presje	1
123–125	2	presje pikë	1 1	presje pikë	1 1
132–136	3	presje pikë	2 1	presje pikë	2 1
164	1	presje	1	presje	2
222	1	presje	1	presje ose pikëçudit je	1
227	1	pikë	1	pikë	1

3.2.2. Intonacioni

Pa e konsideruar intonacionin e segmenteve 1–61 në mënyrë statistike (nuk është ky vendi për një vlerësim të tillë), por vetëm si material bruto, vihet re se, në dyja transkriptimet, *pika* vendoset në rastin e pauzave me intonacion zbritës fundor (shih segmentet: 5, 10, 26, 38, 51; në segmentin 59, F0 zbritet nga 239 Hz në fillim të segmentit te 93 Hz në fund!), ndërsa në segmentet 8, 16, 17, 47, 48, ku u vendosën *presje*, kemi gjithnjë intonacion ngjites¹⁶.

Në figurat që vijojnë (Fig. 1 dhe 2) jepen dy shembuj të të folurit të informatorit I. B. dhe përkatësisht segmentet 1–4 të materialit të përdorur:

¹⁶ Bën përjashtim segmenti 14, ku kemi një “pohim konstatues” (= *zonja*) pas një numri themelor dhe në fund të të cilit përputhet vendosja e presjes si në Procesverbal, edhe në pikësimin e gjuhëtares, por intonacioni ku pritej ngjites (për shkak të presjes) del në të kundërtën si zbritës.

Sa të përshtatshme janë rregullat e pikësimit në rastin ...




Fig. 1. Folësi I.B., segmenti 1 dhe 2 (në <> zgjatja e pauzave):
 “I nderuar Drejtues i seancës <0.73> zonja dhe zotërinj deputet’




Fig. 2. Folësi I.B., segmenti 2 i përsëritur për të treguar pauzën dhe
 segmentet 3 dhe 4
 “[zonja dhe zotërinj deputet] <222> sapo u tha këtu që ... <102> në
 emër të grave duhet të ngrëjmë një kauzë”

4. Të folurit e emetuar dhe një ndarje e tij e jashtëzakonshme

Deri ku pauzat mund të ndihmojnë për vendosjen e shenjave të pikësimit e kemi parë në paragrafët e mësipërm. Tani, si shembull për të treguar si “pauzat” mund të mos kenë asnjë lidhje me natyrshmërinë e të folurit, po japim një fragment të shkurtër nga një emision/debat në RTK në Prishtinë që morëm nga Belluscio (2018). Folësi është gazetari që drejton debatin dhe fragmenti jep fjalët e para me të cilat hapet emisioni. Edhe në këtë rast shembulli i zgjedhur nuk paraqet vështirësi kuptimore, pra, edhe po të hiqen shenjat e pikësimit, mungesa e tyre nuk pengon as leximin dhe as kuptimin e mesazhit:

4.1. **TEKSTI 4** (me transkriptim ortografik pa shenjat e pikësimit)

“Kuvendi i Republikës së Kosovës ka inicuar procedura dhe ka hedhur hapat e parë për të hartuar një projektligj për mbrojtjen e gjuhës shqipe këtë me një propozim dokument e ka marrë nga Instituti Albanologjik i Kosovës dhe i është dorëzuar komisionit parlamentar për arsim shkencë teknologji kulturë rini e sport”

Siç mund të vërehet, shenjat e pikësimit, po të përdoren, kanë sidomos vlerë stilistike, sepse nuk shtojnë asgjë dhe nuk janë të nevojshme përveç rasteve ku mund të kemi keqkuptime ose për të rregulluar pjesët e shkrimit ku lexuesi mund të ketë dyshime kuptimore. Nga pikëpamja fiziologjike (po i referohemi pikërisht *Teksti 4*), duke mos qenë e mundur të lexohen 52 fjalët kuptimore dhe gramatikore që e përbëjnë, me një frymëmarrje të vetme, atëherë i lihet lexuesit/spikerit ku e gjen më të përshtatshme pauzën për frymëmarrjen.

Tani, po të konsiderojmë mënyrën se si e riprodhoi këtë tekst spikeri i televizionit, atëherë kuptohet vetiu sesi pauzat për frymëmarrjen dhe pauzat e brendshme, të cilat janë sidomos ndërprerje e shkurtër e rrymës së të folurit, të cilat kapen nga ana dëgjimore si ndryshim i intonacionit (intonacion zbritës ose ngjitës), rezultojnë të pakuptueshme dhe paraqesin një problem në rrjedhën e shqiptimit.

Ky që vijon është *Teksti 4* i segmentuar duke u mbështetur në pauzat (numrat 1–7 janë referimet për sonogramet përkatëse që jepen më poshtë):

- 1–3 *Kuvendi i Republikës së Kosovës ka inicuar procedura dhe ka hedhur hapat e parë për të*
[,ku'vɛ:ndi,rɛpu'bli-kəs:əkɔ'sɔ:vəs
kaini'ainibli-kəs:əkɔ'sɔ:vəs,ðɛka'xɛður'xapate'pa:r'pər'tə:]
- 4–5 *hartuar një projektligj për mbrojtjen e gjuhës*
[,xar'tu:ar'nə'prɔjekt'li:]pər'mbrɔjtjɛn'ɛ'zʊəs]
- 6–7 *shqipe këtë me një propozim dokument*
['ʃi:pɛ | 'ktʰə mɛnə'prɔpɔ'zimdoku'mɛntʰ]
e ka marrë nga Instituti Albanologjik i Kosovës
[,ɛka'ma:ŋga: 'insti'tuti ,albanɔɔ'zɪk i kɔ'sɔ:vəs]
dhe i është dorëzuar Komisionit parlamentar për Arsim Shkencë
Teknologji dhe Kulturë Rini e Sport
[ðɛ:iəzɔdər'zu:ar | kɔmi'ɔmɔnit pa'lamen'amenit r'a'sɪm
ʃkɛtk,tʰɛknɔɔ'zi: ðɛkul'ɛkr ri'ikr ,ɛ:s'pɔrt]

Transkriptimi fonetik i ngushtë dëfton si spikeri e ndan të folurit e vet në mënyrë jo të natyrshme, me një pauzë të gjatë për frymëmarrje, sintagmat si “për të | hartuar” dhe “gjuhës | shqipe”. Në segmentin e parë (pjesët 1–3) mund të kuptohet marrja e paprogramuar e frymës pas një rryme të të folurit e përbërë nga gjashtëmbëdhjetë fjalë, d.m.th. pas një segmenti shumë të gjatë, kurse në rastin e dytë, megjithëse segmenti është më i shkurtër, nuk gjejmë shpjegim për një veprim të këtillë¹⁷.

Japim edhe në këtë rast rezultatet e sonagramave ku kemi shënuar ndarjet e brendshme sipas lakores intonacionore dhe sipas pauzave frymëmarrëse (të shënuar në didaskalitë me <>):

¹⁷ Lidhur me aspektin fiziologjik të frymëmarrjes në të folurit spontan dhe në të lexuarit me rëndësi është kontributi i Wang *et al.* (2010).




Fig. 3. Folësi A.K., grupi frymëmarrës i parë:
“1. Kuvendi i Republikës së Kosovës | 2. ka inicuar procedura dhe
ka hedhur hapat e parë | 3. për të $\langle \rangle$”




Fig. 4. Folësi A.K., grupi frymëmarrës i dytë:
“4. hartuar një projektligj | 5. për mbrojtjen e gjuhës $\langle \rangle$”




Fig. 5. Folësi A.K., grupi frymëmarrës i tretë:
“6. shqipe | 7. këtë me një propozim dokument <|”

Mbështetja në pauzat frymëmarrëse (që shënojmë me ||) dhe në lakoren e intonacionit (që shënojmë me |) për të sprovuar një mbivendosje të shenjave të pikësimit në transkriptimin ortografik të të folurit (në kllapa katrore), në këtë rast nuk është e mundur, sidomos për faktin që të gjitha pauzat nuk kanë asnjë lidhje me dinamikën e të folurit dhe as me semantikën e mesazhit, pra rezultati i pritit (por i papranueshëm) do të ishte ky:

(1) Kuvendi i Republikës së Kosovës | [,] (2) ka inicuar procedura dhe ka hedhur hapat e parë | [,] (3) për të || [,] (4) hartuar një projektligj | [,] (5) për mbrojtjen e gjuhës || [,] (6) shqipe | [,] (7) këtë me një propozim dokument || [,] (8) e ka marrë | [,] (9) nga Instituti Albanologjik i Kosovës || [,] (10) dhe i është dorëzuar | [,] (11) komisionit parlamentar për arsim shkencë teknologji kulturë rini e sport || [,]

Ndërsa, sipas kuptimit të mesazhit dhe të strukturës sintaksore, pikësimi jominimal i pritit mund të jetë ky:

“Kuvendi i Republikës së Kosovës ka inicuar procedura[,] dhe ka hedhur hapat e parë[,] për të hartuar një projektligj për mbrojtjen e gjuhës shqipe[;] këtë¹⁸[,] me një propozim-dokument[,] e ka marrë nga Instituti

¹⁸ = “këtë projektligj e hartoi me një propozim-dokument, që e ka marrë nga ...”

Albanologjik i Kosovës dhe i është dorëzuar Komisionit parlamentar për Arsim[,] Shkencë[,] Teknologji[,] dhe Kulturë[,] Rini e Sport.”

5. Përfundime

Kur menduam për këtë temë lidhur me tubimin shkencor kushtuar pikësimit, nuk kishim ende njohuri për larminë e studimeve, të cilat, që prej viteve '60 të shekullit të kaluar, u ishin kushtuar çështjeve specifike lidhur me variantin e folur të gjuhës, me krahasimin midis gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, si edhe një tematike kaq të kushtëzuar, siç është ajo e pauzave në të folurit gojor. Në këtë kontekst patëm edhe mundësi për të parë se si shqipes nuk i është kushtuar deri sot një analizë për strukturën e të folurit spontan nga këndvështrime të ndryshme. Siç kemi vënë në dukje edhe në studimet tona të mëparshme, shqipja nuk ka ende një repertor ose një bazë të dhënash për varietetet e saj të folura. Pra, studiuesve të shqipes bashkëkohore u duhet herë pas here të harxhojnë kohë për të gjetur, falë internetit (pa ndihmën e të cilit një punim i këtillë do të ishte i pamundur), materialet që nevojiten.

Në fund të këtij studimi, i cili duhet konsideruar si një provë fillestare në fushën e analizës ritmike, intonacionore dhe të pauzave në shqipen e folur, del qartë se:

a) Gjuha e folur ka strategjitë e veta dhe nuk ka si qëllim kryesor transformimin në gjuhë të shkruar, pra nga kjo rrjedhin disa përfundime:

b) Shenjat e pikësimit, të cilat u krijuan për të organizuar gjuhën e shkruar, nuk mund të shërbejnë, ashtu siç u mendua, edhe për gjuhën e folur, pra, për këtë modalitet gojor të gjuhës duhet të përdoret diçka tjetër (të mbahet parasysh se në transkriptimet fonetike Shoqëria Fonetike Ndërkombëtare nuk aplikoi përdorimin e shenjave të pikësimit);

c) Nuk ka mundësi që shenjat e pikësimit t'i mbivendosen automatikisht të folurit, duke u nisur nga vendimet e përgjithshme që autorët japin lidhur me zgjatjen e pauzave në të folur (pra kur thuhet se *presja* tregon një pauzë të shkurtër dhe *pika* një pauzë të gjatë kjo duhet kuptuar në drejtimin “gjuhë e shkruar – lexim” dhe jo “gjuhë e folur (spontane) – shkrim”);

ç) Në rastet kur bëhet kalimi nga gjuha e folur në gjuhën e shkruar (si në rastin e procesverbaleve, të përgjimeve, etj.), duket që transkriptuesi mbështetet sidomos në konvencionin e rregullave të pikësimit, të cilat lidhen më shumë me aspektin semantik të mesazhit dhe me strukturën e tij sintaksore sesa me intonacionin dhe me pauzat;

d) Vetëm vendosja e *pikave* në fund të fjalive (sipas materialit që kemi përdorur në këtë studim) tregon një lidhje pothuajse të plotë me dy aspektet akustike të sinjalit: me zbritjen e frekuencës themelore (F0) në fund të segmentit dhe me pauzat.

BIBLIOGRAFI

- Belluscio (2018), *A Bifocal Pronunciation of Standard Albanian: Prishtina vs Tirana*. In: L. Jusufi, "The Potentiality of Pluricentrism: Albanian case studies and beyond". Albanische Forschungen. Wiesbaden: Harrassowitz, 89–120.
- Belluscio, G. 2016, *Varietete/variante fonetike "tendenciale" në përdorimin e kontrolluar të shqipes standarde në një emision televiziv të sotëm*. Në: *Aktet e Seminarit XXXV ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare* (Prishtinë, 15–26 gusht 2016), vëll. I, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 403–426.
- Belluscio, G. (2012), *Si shqiptohet shqipja në Ballkan?* Në: R. Ismajli, "Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit". Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 433–472.
- Belluscio, G., Mendicino A., Romito L., *L'albanese standard: vocalismo e strategie temporali*. "Quaderni del Dipartimento di linguistica dell'Università della Calabria", vol. 8, pp. 105–116.
- Cipo, K. (1949, 2015²), *Gramatikë e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Cortelazzo, M. (1985), *Dal parlato al (tra) scritto: i resoconti stenografici dei discorsi parlamentari*. In: G. Holtus, E. Radtke (a cura), "Gesprochenes Italienisch in Geschichte und Gegenwart. Tübingen": G. Narr Verlag, 86–118.
- Dechert, H., M. Raupach, *Temporal Variables in Current Speech. Studies in honour of Frieda Goldman Eisler*. The Hague: Mouton Publishers.
- Garrett, M.F., Bever T.G., Fodor J.A. (1966), *The active use of grammar in speech perception*. "Perception and Psychophysics" 1, 30–32.
- Giannelli, L. (1992), *Sul valore comunicativo delle pause "vuote" nella narrazione del proverbio, nella prospettiva funzionale della frase*. In: Cresti E., N. Maraschio, L. Toschi, "Storia e teoria dell'interpunzione". Atti del Convegno Internazionale di Studi (Firenze, 19–21 maggio 1988). Roma: Bulzoni 1992, 311–354.

- Halliday, M. A. (1992, 1985¹), *Lingua parlata e lingua scritta*. Firenze: La Nuova Italia.
- Hamiti, V. (2017), *Gjuha shqipe e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës*. Në: “Aktet e Seminarit XXXV ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare” (Prishtinë, 15–26 gusht 2016), vëll. I, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 145–155.
- Punimet e Kuvendit* [të Republikës së Shqipërisë]. *Seancat plenare*. Viti 2016, 1, Botim i Kuvendit, Tiranë, 2017. Përgatiti për botim Drejtoria e Shërbimit të Botimeve Parlamentare.
- Lloshi, Xh. (1999), *Stilistika e gjuhë shqipe dhe pragmatika*. Tiranë: Albas.
- Sornicola, R. (1981), *Sul parlato*. Bologna: Il Mulino.
- Voghera, M. (1992), *Sintassi e intonazione nell’italiano parlato*. Bologna: Il Mulino.
- Wang, Y-T., J. R. Green, I. S.B. Nip, R. D. Kent, J. F. Kent (2010), *Breath Group Analysis for Reading and Spontaneous Speech in Healthy Adults*. “Pholia Phoniatria and Logopædica”, 62 (6). 297–302.
- Xanoni (= Zannoni), A. (1909), *Gramatika shqype qi perdoret n’ Seminarë e n’ Mbësotore t’ Sh’ Françesk Saverit n’ Shkoder*. Shtypshkroja e Zojës Paperlyeme, Shkodër.
- Zellner, B. (1994). *Pauses and the temporal structure of speech*. In E. Keller, “Fundamentals of speech synthesis and speech recognition”. Chichester: John Wiley, 41–62.